



Leicestershire  
**Police**  
Protecting our communities

# Abuzimi në familje – ku të merrni ndihmë gjatë pandemisë COVID-19

Ne e dimë që COVID-19 (Koronavirusi) do të ketë një ndikim serioz në jetën e grave, fëmijëve dhe burrave që po hasin abuzim në familje. Frika për vendet e punës, presioni financiar, mbyllja e shkollave, të punuarit nga shtëpia dhe gjithë ndryshimet e tjera aktuale në jetën tonë të përditshme ka gjasa që të rezultojnë në rritjen e incidenteve të abuzimit në familje.

Nëse ju tashmë vuani nga abuzimi në familje, atëherë masat e kufizimeve që janë marrë, ndërsa qeveria përpiqet të ngadalësojë përhapjen e virusit, ndoshta ju kanë lënë të frikësuar se do të izoloheni në shtëpi me abuzuesin tuaj dhe sikur nuk ka asnjë vend ku të shkoni për ndihmë. Ju mund të mos jeni në gjendje t'i takoni miqtë dhe familjen, të cilët zakonisht ju mbështesin dhe disa prej vendeve ku shkoni për ndihmë ose trajtim mund të jenë mbyllur ose mund të ofrojnë një shërbim të reduktuar. Lutemi mos harroni se ju ende mund të telefononi **999** në qoftë se ju apo dikush tjetër është në rrezik.

Ndërsa disa shërbime mbështetëse të abuzimit në familje nuk janë në gjendje

të ofrojnë takime ballë për ballë në këtë periudhë, ka ende ndihmë dhe këshillë të disponueshme online (internet) dhe në telefon.

Këto organizata vendore dhe kombëtare po punojnë shumë për të siguruar që ato ende mund t'ju ndihmojnë:

## United Against Violence and Abuse (UAVA)

Shërbimet e Abuzimit në familje dhe atij seksual në Leicester, Leicestershire dhe Rutland

**0808 802 0028**

[www.uava.org.uk](http://www.uava.org.uk)

## National Domestic Abuse Helpline

Mbështetje për abuzimin në familje, dhunën seksuale, gjymtimin gjeneral femëror, martesat me zor, dhunën për arsye nderi dhe trafikimin/sklavërinë e qenieve njerëzore.

**0808 2000 247 (Telefon falas 24 orë)**

[www.refuge.org.uk](http://www.refuge.org.uk)

Në qoftë se jeni fëmijë apo i ri/e re dhe në shtëpinë apo në marrëdhënien tuaj ka abuzim në familje, atëherë telefononi **Childline** në **0800 1111**.



[leics.police.uk](http://leics.police.uk)



Leicestershire Police



@LeicsPolice